

STUDENTË !!!

**THUJINI JO KORRUPSIONIT!
MOS KONTRIBUONI NË PËRHAPJEN E TIJ!
DENONCOJENI ATË!**

A e dini se?

- Vota juaj ka 10% peshë në zgjedhjen e Dekanit dhe Rektorit në Fakultetin / Universitetin tuaj;
- Senati Akademik përbëhet në masën 10% nga përfaqësues të studentëve të zgjedhur nga ju.

**Ju mund të drejtoheni
pranë këtyre organeve
për çdo rast korrupsioni dhe
të kërkon ndëshkimin e tij.**

**Korrupsioni në Arsimin e Lartë nuk
është vetëm një vepër penale.
Ai çënon cilësinë e arsimit,
dinjitetin e studentëve
dhe të ardhmen e tyre!**

Materialet informuese janë përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të iniciativës “Lufta kundër korrupsionit fillon nga studentët e drejtësisë që zgjedhin integritetin”, me mbështetjen e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC). Opinionet e shprehura në këtë material nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.

Ju mirëpresim në forumet dhe diskutimet tona:

- 🌐 www.altri.al
- ✉ qendra.altri@gmail.com
- 📞 info@altri.al



**STUDENTË DENONCONI
KORRUPSIONIN!
ZGJIDHNI
INTEGRITETIN!**

Si të veproni nëse përballeni me një rast korrupsioni?

- Vini menjëherë në dijeni Drejtuesin e Njesisë Bazë, Dekanin dhe Rektorin
- Informoni Këshillin e Studentëve
- Denonconi rastin në Prokurori
- Bëjeni rastin sa më publik. Mos kini frikë nga pasojat. Vetëm kështu shkelësi do dënohet!

Në rastet e verifikimit të akteve të korrupsionit nga personeli akademik dhe organet drejtuese të Institucionit të Arsimit të Lartë, merren masat e mëposhtme:

- Ministri për arsimin pezullon rektorin dhe i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e tij, i cili shprehet brenda një muaji;
- Rektori i propozon ministrit për arsimin shkarkimin e dekanit. Ministri shprehet brenda një muaji;
- Dekani i propozon rektorit shkarkimin e autoritetit drejtues të njesisë bazë;
- Drejtuesi i njesisë bazë i propozon rektorit largimin nga detyra te personelit akademik të njesisë. Vendimi miratohet paraprakisht nga komisioni adhoc, i ngritur nga Senati Akademik.

Cilat janë pasojat e korrupsionit në Arsimin e Lartë juridik?

- Dëmton cilësinë e përgatitjes tuaj profesionale. Cënon dinjitetin dhe integritetin moral dhe pastërtinë e figurës suaj.
- Vlerësim jo i drejtë dhe objektiv i njohurive dhe përgatitjes suaj bazuar në parimin e meritokracisë.
- Ju demoralizon në arritjen e performancës së duhur nga ana juaj.
- Sjell uljen e besueshmërisë së publikut në Sistemin e Drejtësisë, pjesë e të cilit jeni dhe ju



Nëse mendoni se jeni para një vlerësimi jo-të drejtë nga një pedagog, ndiqni procedurën administrative të ankimit. Kërkoni të drejtën tuaj!

Këshilli i Studentëve

- Është organizimi i pavarur i studentëve që promovon dhe koordinon pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Institucionit të Arsimit të Lartë;
- Shpreh mendime dhe propozime për problematika të ndryshme të Institucionit të Arsimit të Lartë dhe studentëve;
- Zgjidhet çdo dy vjet nga studentët me votim të përgjithshëm të tyre;
- Financohet për veprimtarinë e tij nga Institucioni i Arsimit të Lartë.

Këshilli i Studentëve është zëri juaj kryesor në Fakultet. Përdoreni për të ndikuar në vendimmarrjen akademike institucionale dhe ndëshkimin e korrupsionit.

Mbroni interesat tuaja!